



Planuar / Dorezuar Punë/Prodhim Recizuar / Deliverty	20-04	2021	1	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org / Unit	SKOPSACK	1905/2021		Sasia Kolicina Quantity
				115

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.224/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-Kryetar, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi-Bajraktari me Flakron Gashi Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative A.nr.886-2019 të datës 15.03.2021, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.14/2019 të datës 15.01.2019 me numër protokoll 186/2019 parashtruar nga ankuesi

kundër Vendimit 02.Nr.112-8046/2018 të datës 21.12.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Klinës, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 20.04.2019, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa me numër A.nr.14/2019 e datës 15.01.2019 e parashtruar nga ankuesi

II. SHFUQIZOHET Vendimi i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Komunës së Klinës i datës 21.12.2018 me 02.Nr.112-8046/2018 si dhe **anulohet** procedura rekrutimit për vendin e punës Sekretar në SHFMU “Ali Krasniqi” në Ujmirë me plotësim norme në Shkollën e Qabiqit me numër të referencës JP00034247 si dhe të gjitha veprimet që rrjedhin nga kjo procedurë.

III. OBLIGOHET Kryetari i Komunës së Klinës, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit ligjor prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ministria e Administratës Publike/Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil, me datë 26.09.2018 ka aprovuar kërkesën e Komunës së Klinës, për autorizimin e shpalljes së konkursit për pozitën: Sekretar i Shkollës “Ali Krasniqi” në Ujmirë me plotësim norme në shkollën e Qabiqit AR/680/JP00034247.

Pas marrjes së miratimit nga Ministria e Administratës Publike/Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil, Komuna e Klinës me datë 28.09.2018, ka publikuar konkursin për plotësimin e vendit të lirë të punës Sekretar në SHFMU “Ali Krasniqi” në Ujmirë me plotësim norme në Shkollën e Qabiqit me numër të referencës JP00034247.

Ankuesi ka aplikuar në konkursin e shpallur të datës 28.09.2018 nga Komuna e Klinës, për vendin e punës Sekretar në SHFMU “Ali Krasniqi” në Ujmirë me plotësim norme në Shkollën e Qabiqit. Pas njoftimit zyrtar të datës 07.11.2018, për përzgjedhjen përfundimtare të kandidatit nga Komuna e Klinës, ankuesi i pa kënaqur me këtë përzgjedhje përfundimtare për pozitën e lartë cekur, me datë 30.11.2018, ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 112-8046/18 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Klinës.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Komunës së Klinës, ka marr vendimin 02.Nr.112-8046/2018 të datës 21.12.2018, me të cilin i refuzohet ankesa e ankuesit si e pa bazuar dhe ka lënë në fuqi shpalljen publike të rezultateve të datës 07.11.2018 për kandidatin e suksesshëm.

Ankuesi i pa kënaqur me vendimin e datës 21.12.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Klinës, me datë 15.01.2019 ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 186/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 16.01.2019 e ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Komunën e Klinës. Më datë 16.01.2019 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Klinës, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesa e ankuesit e datës 15.01.2019 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 21.12.2018 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Klinës; Kërkesa e ankuesit e datës 14.11.2018 për qasje në dokumente publike; Vendimi i datës 23.04.2018 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Klinës; Autorizimi i datës 26.09.2018 i Ministrisë së Administratës Publike/Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil; Konkursi i datës 28.09.2018; Zgjatja e afatit të konkursit e datës 12.10.2018; Vendimi i datës 22.10.2018 për themelimin e Komisionit Përzgjedhës të Shërbimit Civil; Përcaktimi i kriterëve për përfshirjen në listën e ngushtë (Form.MAP-SHCK-05); Përcaktimi i kriterëve për testimin me shkrim dhe me gojë për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj (Form.MAP-SHCK-07a); Njoftimi i kandidatëve për testimin nga përzgjedhja e ngushtë (Form.MAP-SHCK-06); Njoftimi për testimin me shkrim të kandidatëve e datës 29.10.2018; Njoftimi i datës 01.11.2018 për rezultatet e testimit me shkrim; Njoftimi i datës 05.11.2018 për rezultatet e testimit me shkrim dhe me gojë; Përmbledhja e vlerësimeve individuale (Form.MAP-SHCK-09); Renditja përfundimtare e kandidatëve (Form.MAP-SHCK-10); Publikimi i rezultateve i datës 07.11.2018; Formulari i Aplikimit i datës 09.10.2018 me dokumentacionin e bashkangjitur; Formulari i Aplikimit i datës 28.09.2018 me dokumentacionin e bashkangjitur; Formulari i Aplikimit i datës 01.10.2018 i kandidatit Formulari i Aplikimit i datës 04.10.2018 me dokumentacionin e bashkangjitur; Testi me

shkrim; Vlerësimi individual i kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj (Form.MAP-SHCK-08a) si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës, Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative A.nr.886-2019 të datës 15.03.2021, Njoftimin e datës 29.03.2019 të Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje. pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit **është e bazuar sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se ankuesi në bazë të aplikacionit të datës 14.10.20218 ka aplikuar në konkursin për pozitën “Sekretar Shkolle në SHFMU “Ali Krasniqi” në Ujmirë me plotësim norme në Qabiq”.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka shqyrtuar pretendimet ankimore i cili pretendon se procedura e rekrutimit për pozitën e shpallur në konkursin e datës 28.09.2018 është zhvilluar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.03-L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës neni 18 paragrafi 1, si dhe dispozitat e Rregullores Nr.02-10 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, duke u bazuar në dokumentacionin e dërguar nga Komuna e Klinës ka konstatuar se, sipas konkursit të datës 28.09.2018 kushtet kriteret e konkursit kanë qenë: “Diplomë Universitare-Fakulteti Juridik dhe Ekonomik; 2 vite përvojë pune, etj”.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, gjatë analizimit të provave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil me datë 25.10.2018 ka përgatitë listën e shkurt prej tre (3) kandidatëve, ku në listën e shkurtë ka përfshi edhe kandidaten e cila ka marrë pjesë në të gjitha fazat e procedurës, e që në bazë të dokumentacionit të bashkangjitur në aplikacionin e datës 28.09.2018 posedon Diplomën me numër nr:4477 të datës 13.02.2017 me të cilën dëshmohet se e njëjta ka mbaruar studimet në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës me datë 02.12.2016, ndërsa sipas Akt Emërimit të datës 01.02.2017 ka qenë e angazhuar në cilësinë e praktikantës vullnetare në Gjykatën Themelore në Pejë, nga rrjedh se ankuesja me rastin e aplikimit në konkursin e datës 28.09.2018 ka pasur 1 (një) vit përvojë punë pas diplomimi, andaj me rastin e përfshirjes së saj në listën e shkurtër si dhe procedurat e tjera të konkursit Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil, ka vepruar në kundërshtim me nenin 28 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil i cili ka përcaktuar se: “1.Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve në vijmë:1.2. përvoja e punës”, si dhe në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.03-L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës neni 11 paragrafi 1 i cili përcakton se: “Pranimi në Shërbimin Civil të Kosovës bëhet në pajtim me parimet e meritës, aftësisë profesionale, paanshmërisë, mundësive të barabarta, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë, në bazë të konkursit publik dhe pas verifikimit të zotësisë së veprimit të kandidatëve” si dhe nenin 18 paragrafi 1 i të njëjtit ligji i cili përcakton se: “Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitave të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mosdiskriminimin e kandidateve dhe të drejtën për t’u ankuar në fund të procedurës”, pasi që kandidatja Lirie Gashi nuk i ka plotësuar të gjitha kushtet dhe kriteret e konkursit të datës 28.09.2018 i shpalluar në bazë të autorizimit të Departamentit të Administrimit të Shërbimit Civil/Ministrisë së Administratës Publike të datës 26.09.2018 sa i përket përvojës së punës prej dy (2) viteve.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit i cili ka pretenduar se nuk ka pas numër të mjaftueshëm të kandidatëve. Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankuesit nuk është i bazuar pasi që i njëjti konkurs ka qenë i hapur edhe me datë 03.04.2018 dhe me dispozitat e nenit 29 paragrafit 2 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil është përcaktuar se: *“Pas rishpalljes së pozitës, KPSHC bën përzgjedhjen edhe nëse ka më pak se tre kandidatë adekuat për listën e shkurtë”*.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit i cili ka pretenduar se kandidati i përzgjedhur nuk i ka plotësuar kushtet dhe kriteret e konkursit sepse nuk e ka shkollimin adekuat. Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankuesit nuk është i qëndrueshëm sepse Ministria e Administratës Publike/Departamenti i Shërbimit Civil me datë 26.09.2018 ka aprovuar shpalljen e konkursit për vendin e punës Sekretar në SHFMU “Ali Krasniqi” në Ujmirë me plotësim norme në Shkollën e Qabiqit, me kriteret si në vijmë: Diplomë Universitare Fakulteti Ekonomik dhe Juridik, duke mos i përcaktuar degët e fakultetet ekonomik dhe që një gjë e tillë nënkupton se janë përfshirë të gjitha degët e Fakultetit Ekonomik dhe se kandidati i përzgjedhur i ka plotësuar kushtet dhe kriteret e konkursit për sa i përket përgatitjes profesionale dhe asaj të përvojës së punës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Klinës me rastin e nxjerrjes së Vendimit me 02.Nr.112-8046/2018 të datës 21.12.2018, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën Administrative, Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil dhe Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, sepse nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave meqenësë ka konstatuar se pretendimit i ankuesit se procedura e rekrutimit për pozitën e shpallur në konkursin e datës 28.09.2018 është zhvilluar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.03-L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës neni 18 paragrafi 1, është i bazuar pasi që kandidata Lirije Gashi e cila është përfshi në listën e shkurt nga Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil përderisa nuk i ka plotësuar kriteret e konkursit, andaj mbi këtë bazë Kolegji ka aprovuar ankesën e ankusit ndërsa ka anuluar procedurën e rekrutimit për konkursin e lartcekur.

Me dispozitat e nenit 21 paragrafit 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është përcaktuar se: *“Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës”*, dhe me dispozitat e nenit 24 paragrafit 1 të po këtij ligji është përcaktuar se: *“Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit sipas nenit 21 të këtij ligji, Kryetari i Këshillit nxjerr vendim për ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit”*.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.224/2021

Elakron GASHI


Zyrtar i Lartë për Bashkpunim Profesional

Eshref SHABANI



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunes se Klinës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Klinës;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

